

Procesverbal

Konsultim publik : *Banorët e bashkisë Maliq.*

Data : 15.06.2022

Ora : 12.00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *40 banorë, nga të cilët 25 gra dhe vjaza, dhe 15 burra*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Konsultimi Publik për draftin e parë të PBA 2023-2025, organizuar nga Këshilli i Bashkisë.

Pjesëmarrës : Shoqata e Biznesit, OJF, Përfaqësues nga Shoqëria Civile, Drejtues Institucionesh, Qytetarë, Studentë-Nxënës, Administrata.

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit i cili bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me prioritetet e tavneve boxhetore 2023-2025 të dalë nga plotësimi i pyetësorit nga qytetarët :

Këshilli Bashkiak Maliq e nisi komunikimin me juqë në muajin shkurt, për ta marrë mendimet tuaja përmes një pyetësi on – line për prioritetet e qytetarëve në lidhje me Tavanet Përgatitore Buxhetore për PBA 2023-2025.

Duke falënderuar qytetarët që e plotësuan pyetësin dhe dhënë mendimin e tyre, ju informoj se jeni fokusuar në prioritetet e mëposhtme:

- **Aftësim dhe punësim**
- **Shërbimet bujqësore**
- **Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara**
- **Kujdesi social për familjet dhe fëmijët**
- **Sport dhe argetim**
- **Arsim i mesëm**
- **Strehimi**
- **Arsimi bazë dhe parashkollori**
- **Rrjeti rrugor**

Ndërkohe që edhe funksionet

- Trashegimnia kulturore
- Pyjet dhe kullotat
- Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
- Sigurim shoqeror
- Policia vendore....

vijojne te mbeten ne vemendjen e bashkise.

Pas prezantimit në lidhje me draft PBA 2023-2025 nga ana e Kryetarit të Bashkisë, pjesëmarrësit që morën fjalën dhe diskutuan, dhanë rekomandimet përkatëse si vijon :

- 1-Rritja e kujdesit për moshën e tretë, krijimi i Qendrës për moshën e tretë.
- 2-Rritja e kujdesit për fëmijët me aftësi të kufizuar (transport për te qendra komunitare)
- 3-Investime për ngritjen e ambejneteve sportive pranë shkollave.
- 4-Investime për rehabilitimin e shkollave në territorin e bashkisë.
- 5- Restaurim i lapidareve dhe simboleve të përkujtimit dhe respektit për të rënë.
- 6- Investime për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve Rurale.
- 7-Shtimi i këndeve të lojrave për fëmijë dhe shesheve sportive.
- 8-Sigurimi i druve të zjarrit për banorët e bashkisë Maliq.
- 9- Investime për ndërtimin e sistemve të ujit të pijshëm.
- 10-Investime në Arsimin parashkollor.(rehabilitim/ndërtim kopshtesh)
- 11-Ndërhyrje në rrugët lidhëse të parcelave.
- 12- Ndërhyrje për rehabilitimin e sistemve të ujitje-kullimit.

Mbajtësi i procesverbalit Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI

